



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Deklarimi Vjetor dhe Raportimi i Pasqyrave Financiare

Shkurt 2025

Legjislacioni Tatimor i Kosovës

Nr.	Emri i Ligjit	Nr. i Ligjit	Nr. i Udhëzimit Administrativ
1	Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore	Nr. 08/L-257	
2	Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - TVSH	Nr. 05/L-037	Nr. 03/2015 Nr. 06/2016
3	Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale – TAP Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore	Nr. 05/L-028 Nr. 08/L-142	Nr. 01/2016
4	Ligji për Tatim në të Ardhurat e Korporatave - TAK	Nr. 06/L-105	
5	Ligji për Kontributet Pensionale - KP	Nr. 04/L-101 Nr. 04/L-168 Nr. 05/L-116	

Normat tatimore

Deri më
31.07.2024

Lloji i tatimit	Qarkullimi	Norma
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - TVSH	Mbi 30,000 euro	8% dhe 18%
Tatimi në të Ardhurat e Korporatave - TAK	Nën pragun për tatuarje reale (30,000 euro)	3%
Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportuese etj.		9%
Veprimtaria shërbyese		
Tatimi në të Ardhurat e Korporatave - TAK	Mbi pragun për tatuarje reale (30,000 euro)	10%
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP	Nën pragun për tatuarje reale (50,000 euro)	3%
Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportuese, etj.		9%
Veprimtaria shërbyese		
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP	Mbi pragun për tatuarje reale (50,000 euro)	0%
Të ardhurat Vjetore nga 0 deri 960.00		4%
Të ardhurat Vjetore nga 960.01 – 3,000.00		8%
Të ardhurat Vjetore nga 3,000.01 deri 5,400.00		10%
Të ardhurat Vjetore nga 5,400.01 e tutje		
Tatimi i mbajtur në burim në Paga (mujor)		0%
Të ardhurat mujore nga 0 deri 80.00		4%
Të ardhurat mujore nga 80.01 – 250.00		8%
Të ardhurat mujore nga 250.01 – 450.00		10%
Të ardhurat mujore nga 450.01 e tutje		
Tatimi në Qira		10%
Tatimi i mbajtur në burim në qira		9%
Tatimi i mbajtur në burim në interes		10%
Tatimi i mbajtur në burim në të drejta pronësore		10%
Tatimi i mbajtur në burim për kategori të veçanta	Varësisht nga statusi i biznesit	1% ose 3%
Tatimi i mbajtur në burim për jo-rezidentët		5% apo METD

Normat tatimore

Nga data
01.08.2024

Lloji i tatimit	Qarkullimi	Norma
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - TVSH	Mbi 30,000 euro	8% dhe 18%
Tatimi në të Ardhurat e Korporatave - TAK Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportuese etj. Veprimtaria shërbyese	Nën pragun për tatuarje reale (30,000 euro)	3% 9%
Tatimi në të Ardhurat e Korporatave - TAK	Mbi pragun për tatuarje reale (30,000 euro)	10%
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportuese, etj. Veprimtaria shërbyese	Nën pragun për tatuarje reale (50,000 euro)	3% 9%
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP Të ardhurat Vjetore nga 0 deri 3,000.00 Të ardhurat Vjetore nga 3,000.01 deri 5,400.00 Të ardhurat Vjetore nga 5,400.01 e tutje	Mbi pragun për tatuarje reale (50,000 euro)	0% 8% 10%
Tatimi i mbajtur në burim në Paga (mujor) Të ardhurat mujore nga 0 deri 250.00 Të ardhurat mujore nga 250.01 – 450.00 Të ardhurat mujore nga 450.01 e tutje		0% 8% 10%
Tatimi në Qira		10%
Tatimi i mbajtur në burim në qira		9%
Tatimi i mbajtur në burim në interes		10%
Tatimi i mbajtur në burim në të drejta pronësore		10%
Tatimi i mbajtur në burim për kategori të veçanta	Varësisht nga statusi i biznesit	1% ose 3%
Tatimi i mbajtur në burim për jo-rezidentët		5% apo METD

Deklarimi i tatimeve dhe korigjimi i tyre

- Çdo person që i nënshtrohet çdo lloj tatimi sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, dorëzon në ATK ose tek bankat apo institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës Kosovës, një deklaratë të plotësuar sipas kërkesave të Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore.
- Obligimi për të plotësuar dhe dorëzuar Deklaratën Tatimore si dhe përmbajtja e saj.
- Vetëvlerësimi i detyrimit tatimor.
- Korigjimi i deklaratës tatimore i lejuar brenda tre (3) viteve pas datës obligative kur deklarata është kërkuar të dorëzohet fillimisht.
- Në rastet kur punëdhënësi nuk kërkohet të mbajë në burim tatimin apo kontributin pensional, atëherë i punësuari duhet të dorëzojë një deklaratë dhe të paguajë në fund të vitit ose në periudhën mujore kur i përfiton mjetet.

Pagesat e tatimit

- Çdo tatim që përbën detyrim dhe që duhet t'i paguhet ATK është një borxh ndaj ATK.
- Pagesa e tatimit do të bëhet në vendin dhe kohën e përcaktuar nga ATK.
- Të gjitha tatimet do të paguhen në banka apo institucione tjera financiare, të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës Kosovës (BQK).

Tatimpagues

- **Kush janë tatimpagues për TAP?**
 - Personat fizikë rezident dhe jo rezident;
 - Ndërmarrja personale afariste;
 - Ortakëritë dhe Shoqëritë, të cilat pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto.
- **Kush janë tatimpagues për TAK?**
 - Korporatat apo ndonjë ndërmarrje tjetër që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë;
 - Organizatat jo-qeveritare (OJQ-të);
 - Ndërmarrjet që veprojnë me asete Shoqërore apo Publike;
 - Njësitë e përhershme.

Objekt i tatimit

- Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme nga burimi i të ardhurave nga Kosova dhe burimi i të ardhurave nga jashtë;
- Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo-rezident janë të ardhurat e tatueshme ato që e kanë burimin në Kosovë.

Të Ardhurat e Tatueshme

Të ardhura të tatueshme për një periudhë të tatueshme janë të ardhurat që rezultojnë nga ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme sipas Legjislacionit tatimor përkatës (TAP ose TAK) lidhur me të ardhurat e tilla bruto.



Deklarimi dhe Pagesa për TAP nga:

- Bizneset Individuale të vogla
- Bizneset Individuale të mëdha

Raportimi i të ardhurave nga Bizneset Individuale të vogla

Personat fizikë afarist (Bizneset Individuale) me të ardhura vjetore bruto nën limitin prej 50,000€ për t'u tatuar në bazë të të ardhurave reale, siç është përcaktuar me Ligjin për Tatim në të Ardhura Personale, do të raportojnë të ardhurat nga veprimtaritë afariste në periudhën tatimore në të cilën ato të ardhura në të vërtetë apo në mënyrë konstruktive janë pranuar.

Normat tatimore për Bizneset Individuale të vogla

- Tre për qind (3%) të të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme ekonomike të çdo tremujori, por jo më pak se 37.50€ për tremujor.
- Nëntë për qind (9%) të të ardhurave bruto nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pak se 37.50€ për tremujor.
- Nëse një tatimpagues nuk ka të ardhura në një periudhë tremujore, nuk kërkohet pagesë, por tatimpaguesi obligohet të dorëzojë deklaratën tremujore për periudhën edhe kur nuk ka obligim tatimor.

Shembulli 1– Deklarimi me formularin IS

- Biznesi “X”, gjatë periudhës TM1/2024, ka këtë qarkullim:
 - Të ardhura bruto nga tregtia 5,000.00€
 - Të ardhura bruto nga shërbimet 2,000.00€

- Detyrimi tatimor dhe Kontributi Pensional nga shembulli 1:
 - Të ardhura nga tregtia $5,000.00 * 3\% = 150.00€$
 - Të ardhura nga shërbimet $2,000.00 * 9\% = 180.00€$

- **Tatimi:** Shuma për pagesë tremujore = $(150.00 + 180.00) = 330.00€$
- **Kontributi Pensional:** $330.00 / 3 = 110.00€$

Shembulli 2– Deklarimi me formularin IS

- Biznesi “X”, gjatë periudhës **TM3/2024**, ka këtë qarkullim:
 - Të ardhura bruto nga tregtia 2,000.00€
 - Të ardhura bruto nga shërbimet 800.00€
 - Detyrimi tatimor dhe Kontributi Pensionsal nga shembulli nr. 2:
 - Të ardhura nga tregtia $2,000.00 * 3\% = 60.00€$
 - Të ardhura nga shërbimet $800.00 * 9\% = 72.00€$
-
- **Tatimi:** Shuma për pagesë tremujore = $(60.00 + 72.00) = 132.00 €$
 - **Kontributi Pensionsal:** $132.00 / 3 = 44.00€$, obligimi për pagesë është 30% i pagës minimale, ku $350.00 * 30\% = 105.00€$, apo vullnetarisht maksimum 132.00€

Shembulli 3– Deklarimi me formularin IS

- Biznesi “X”, gjatë periudhës **TM4/2024**, ka këtë qarkullim:
 - Të ardhura bruto nga tregtia 500.00€
 - Të ardhura bruto nga shërbimet 200.00€
 - Detyrimi tatimor dhe Kontributi Pensional nga shembulli nr. 3:
 - Të ardhura nga tregtia $500.00 * 3\% = 15.00€$
 - Të ardhura nga shërbimet $200.00 * 9\% = 18.00€$
-
- **Tatimi:** Shuma për pagesë tremujore = $(15.00 + 18.00) = 33.00€$, por jo me pak se **37.50€**
 - **Kontributi Pensional:** $37.50 / 3 = 12.50€$, **obligimi për pagesë është 30% i pagës minimale, ku $350.00 * 30\% = 105.00€$**

Raportimi i të ardhurave nga Bizneset Individuale të mëdha

Personat fizikë afarist (Bizneset Individuale) me të ardhura vjetore bruto mbi limitin prej 50,000€, apo ata të cilët vullnetarisht zgjedhin të mbajnë libra dhe regjistrime sipas tatuarjes në të ardhura reale, do të raportojnë të ardhurat nga veprimtaritë afariste në periudhën tatimore gjatë së cilës janë pranuar apo akruar (lindur).

Kush ka për obligim të dorëzojë deklaratën vjetore – PD?

- Bizneset Individuale të mëdha;
- Bizneset Individuale, të cilat kanë zgjedhur të taten në bazë të të ardhurave reale;
- Ortakët;

Normat Tatimore për deklarim të TAP

Norma tatimore	Të ardhurat mujore (€)	Të ardhurat vjetore (€)
0%	0 deri 250.00	0 deri 3,000.00
8%	250.01 deri 450.00	3,000.01 deri 5,400.00
10%	450.01 e tutje	5,400.01 e tutje

Të ardhurat e tatueshme sipas Ligjit për TAP

- Të ardhurat bruto nga pagat;
- Neto e ardhura nga biznesi, ortakëria, qiraja;
- Të ardhurat bruto nga pagesat e pensionit;
- Të ardhurat bruto nga interesi bankar;
- Të ardhurat bruto nga interesi në huatë;
- Të ardhurat bruto nga fitoret në lotari;
- Të ardhurat bruto nga pasuria e patrupëzuar;
- Të ardhurat nga fitimet kapitale;
- Të ardhurat me burim nga jashtë;
- Të ardhurat nga dhuratat;
- Të ardhurat tjera, siç janë: çmimet jo në para të gatshme nga lotaria, borxhet e falura apo të ardhurat tjera të cilat kanë rritur vlerën neto të individit.

Shpenzimet e pranueshme plotësisht dhe pjesërisht sipas Ligjit për TAP

- Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promocionit ekonomik;
- Shpenzimet e borxhit të keq;
- Shpenzimet afariste të udhëtimit;
- Shpenzimet e zhvlerësimit;
- Riparimet dhe përmirësimet;
- Amortizimi;
- Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja;
- Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore;
- Humbjet tatimore (6 vite TAP);
- Shpenzimet e qirasë;
- Zbritjet për Kontributet Pensionale;
- Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik;
- Shpenzimet edukative/arsimore dhe trajnuese etj.

Shpenzimet të cilat nuk pranohen sipas Ligjit për TAP

- Shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të Tokës;
- Shpenzimet e përmirësimit, renovimit dhe rikonstruksionit të mjeteve të cilat janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar (trajtohen si riparimet dhe përmirësimet);
- Gjobat, ndëshkimet dhe interesi që shqiptohen, si dhe shpenzimet dhe i lidhur me to;
- Tatimi në të ardhura i paguar apo akruar;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim;
- Shpenzimet personale, të jetës ose ato familjare;
- Çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur nëse nuk është në harmoni me Vlerën e Tregut;
- Kontributet Pensionale mbi shumën maksimale të lejuar me ligji;
- Shpenzimet për dhurata, përveç atyre që janë me emër dhe logo të biznesit të cilat janë pjesë e shpenzimeve të përfaqësimit;

Shpenzimet të cilat nuk pranohen sipas Ligjit për TAP (vazhdim)

- Humbjet në peshë specifike apo substancë, dëmtimet, mbetjet, tepricat, shkatërrimet apo thyerjet gjatë prodhimit, transportit, magazinimit dhe ekspozimit, përtej normave të përcaktuara me akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;
- Përfitimet në natyrë në formë të shujtës dhe transportit, përveç rasteve kur organizohet nga biznesi;
- Shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve rezident dhe jo rezident;
- Shpenzimet e mbuluara nga grantet, subvencionet dhe donacionet në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- Shpenzimet për dëfrim dhe rekreacion;
- Shpenzimet tjera të përcaktuara me legjislacionin tatimor në fuqi; dhe
- Shpenzimet e pa dokumentuara.

Deklarimi dhe pagesa e TAP

Këstet paradhënie

Për dorëzimin e kësteve paradhënie, ekzistojnë kritere për:

- Vitin e parë të afarizmit;
- Vitin e dytë të afarizmit, e tutje.

Deklarimi i kësteve paradhënie

Viti i parë i afarizmit

- $1/4$ e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit;
- Pagesa në katër këste, ku me pagesën e këstit të katërt mbulon **80%** të obligimit tatimor.

Deklarimi i kësteve paradhënie

Viti i dytë i afarizmit e tutje

Tatimpaguesi mund të zgjedhë njërin nga opsionet, si:

- **1/4** e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit, apo
- **110%** të detyrimit tatimor nga viti paraprak të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit.

Këstet paradhënie

Përjashtimet:

- Tatimpaguesi i cili krijon humbje;
- Tatimpaguesi tek i cili ushtrohet kontrolli tatimor dhe devijimi kalon mbi **20%** në atë vit.

Shembulli 1: Deklarimi me formularin IL

- Biznesi “X”, gjatë periudhës **TM3/2024**, ka këtë detyrim tatimor parashikuar (Opsioni A) për vitin **2024**:
 - Të ardhura e parashikuara $1,000,000.00 / 4 = 250,000.00\text{€}$
 - Shpenzimet e parashikuara $700,000.00 / 4 = 175,000.00\text{€}$
 - Të ardhurat e tatueshme, para zbritjes së Kontributit Pensionsal $300,000.00 / 4 = 75,000.00\text{€}$
- Nga të ardhurat e tatueshme së pari ndahet 10% në emër të Kontributit Pensionsal për të vetëpunësuarin e pastaj llogaritet Tatimi në të Ardhura Personale.

Shembulli 1: Deklarimi me formularin IL

- Pra, $300,000.00 * 10\% = 30,000.00\text{€}$ Kontribut Pensional, maksimum 2,400.00€ në vit (maksimum 600.00€ në këste).
- Të ardhurat e tatueshme të parashikuara $300,000.00\text{€} - 2,400.00\text{€} = 297,600.00\text{€}$

Norma tatimore	Të ardhurat vjetore (€)	Diferenca(€)	Tatimi në të Ardhura Personale(€)
0%	0 deri 3,000.00	3,000.00	-
8%	3,000.01 deri 5,400.00	2,399.99	192.00
10%	5,400.01 deri 297,600.00	292,199.99	29,220.00
Gjithsej Tatimi i Parashikuar			29,412.00

Shembulli 1: Deklarimi me formularin IL

- **Tatimi** = 7,353.00€ (nxjerrë nga obligimi vjetor në bazë të shkallëve tatimore pjesëtuar për 4, pra $29,412.00 / 4 = 7,373.40€$)
- **Kontributi Pensional** =7,500.00€ obligim, mirëpo është definuar me Ligj të Kontributeve Pensionale se shkalla e obligueshme e KP për Bizneset e mëdha individuale është 10% deri në 30% e të ardhurave, para zbritjes së KP, ose 600.00€, cilado që është më e ulët. Pra, maksimumi do të jetë 600.00€, minimumi 30% i **pagës minimale në Kosovë**, pra **105.00€** ($350.00 * 30% = 105.00$).
- Në këtë rast obligimi për Kontribute Pensionale është 600.00€.

Shembulli 2: Deklarimi me formularin IL

- Biznesi “X”, gjatë periudhës **TM1/2024**, ka përzgjedhë Opsionin B për të deklaruar këstet e vitit aktual. Pra, këstet paradhënie për vitin **2024** do t’i deklaroj 110% më tepër se sa obligimi i vitit të kaluar. Obligimi tatimor në vitin e kaluar ishte 20,000.00€
- Pagesë paradhënie me 110%
- **Obligimi tatimor** - pagesë paradhënie për vitin e tanishëm $20,000.00 + 10\% = 22,000.00 / 4 = 5,500.00€$
- **Kontributi Pensional** = $2,400.00€$ maksimum / 4 = $600.00€$ maksimum në këste.

Afatet kohore për deklaram - TAP

- Secili tatimpagues i cili realizon apo akruon të ardhura nga veprimtaritë afariste paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga Administrata Tatimore në një bankë apo institucion financiar të licencuar nga BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar).
- Për këstet paradhënie, afati i deklaramit nga 1 deri më 15 të muajit vijues pas çdo tremujori.
- Për deklaratën vjetore për TAP afati i deklaramit nga 1 Janar deri më 31 Mars të vitit pasues të periudhës tatimore.

Përpilimi i deklaratës tatimore

Deklarata tatimore konsiderohet vlerësim i bërë nga vet tatimpaguesi dhe përmban:

Deklaratën financiare

- Të ardhurat bruto lidhur me aktivitetet operative;
- Shpenzimet lidhur me aktivitetet operative;
- Aktivitetet jo-operative;
- Të ardhurat neto ose humbja.

Përpilimi i deklaratës tatimore

Deklaratën tatimore

- Të ardhurat e tatueshme;
- Zbritjet;
- Zbritjet tjera (si p.sh. humbjet e bartura);
- Tatimi i mbajtur në burim gjatë vitit;
- Tatimin për pagesë;
- Kërkesë për rimbursim.

Përpilimi i deklaratës tatimore

Shuma përfundimtare e tatimit, është shuma e përgjithshme e tatimit për periudhën tatimore minus:

- Shumat e Tatimit të Mbajtur në Burim dhe të paguara nga të tjerët;
- Shumat e paguara në këste tremujore - paradhënie;
- Krediti i jashtëm tatimor i lejuar sipas Ligjit për TAP.



Përpilimi i deklaratës tatimore

Varësisht nga kalkulimet mund të paraqiten këto situata:

- Obligim për pagesë;
- Pagesë tepër;
- Kërkesë për Rimbursim.

Deklarimi i formularit PD përmes Sistemit EDI

www.atk-ks.org



Shembull – Deklarimi Vjetor me formularin “PD”

Personi “X”, gjatë vitit 2024 ka pasur, transaksionet, si në vijim:

TË ARDHURAT	
Të ardhurat bruto lidhur me aktivitetet operative	520,000.00 €
Të ardhurat bruto nga Pagat - Punëdhënësi "Y"	17,000.00 €
Të ardhurat neto nga ortakëritë	60,000.00 €
Të ardhurat bruto nga Qiratë	12,000.00 €
Të ardhurat bruto nga interesi	1,200.00 €
Të ardhurat nga Fitimet kapitale	5,000.00 €
Të ardhurat me burim nga jashtë	16,000.00 €
Të ardhura tjera përfshire dhuratat	6,000.00 €
Gjithsej të ardhurat	637,200.00 €

SHPENZIMET	
Pagat bruto të punëtorëve	27,000.00 €
Shpenzimet për zhvlerësim dhe amortizim	8,200.00 €
Shpenzimet e shitjes	1,000.00 €
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	4,500.00 €
Shpenzimet për kontribute pensionale për punëtor	1,350.00 €
Shpenzimet tjera operative	1,200.00 €
Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e qirasë-reale ose 10% të qirasë bruto	1,200.00 €
Shpenzimet për kontributet pensionale për pronarin	3,250.00 €
Shpenzimet tjera të lejueshme	200.00 €
Gjithsej shpenzimet	47,900.00 €

INFORMATA TJERA	
Humbjet e bartura nga viti 2023	1,200.00 €
Shpenzim / Pagesë për kontribute bamirëse	3,000.00 €
Tatimi i mbajtur në burim në paga nga punëdhënësi "Y"	873.60 €
Tatimi i mbajtur në burim mbi interesin	120.00 €
Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë	1,080.00 €
Kreditimi i tatimit të huaj	1,600.00 €
Pagesat tremujore paradhënie mbi të ardhurat nga biznesi	8,600.00 €
Stoku në fillim, më 01.01.2024	158,000.00 €
Blerjet apo kostoja e prodhimit gjatë vitit 2024	298,000.00 €
Stoku në fund, më 31.12.2024	125,000.00 €

■ Zgjidhja:

Obligimi për pagesë = 12,788.40€

Deklarimi dhe Pagesa për TAK nga :

- Korporatat e vogla
- Korporatat e mëdha

Raportimi i të ardhurave nga Korporatat e vogla

Personat juridikë (Korporatat) me të ardhura vjetore bruto nën limitin prej 30,000€ për t'u tatuar në bazë të të ardhurave reale, siç është përcaktuar me Ligjin për Tatim në të Ardhurat e Korporatave, do të raportojnë të ardhurat nga veprimtaritë afariste në periudhën tatimore në të cilën ato të ardhura në të vërtetë apo në mënyrë konstruktive janë pranuar.

Normat tatimore për Korporatat e vogla

- **Tre për qind (3%)** të të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme ekonomike të çdo tremujori, por jo më pak se 37.50€ për tremujor.
- **Nëntë për qind (9%)** të të ardhurave bruto nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori, por jo më pak se 37.50€ për tremujor.
- Nëse një tatimpagues nuk ka të ardhura në një periudhë tremujore, nuk kërkohet pagesë, por tatimpaguesi obligohet të dorëzojë deklaratën tremujore për periudhën edhe kur nuk ka obligim tatimor.

Shembulli 1– Deklarimi me formularin QS

- Biznesi “X”, gjatë periudhës **TM1/2024**, ka këtë qarkullim:
 - Të ardhura bruto nga tregtia 5,000.00 euro
 - Të ardhura bruto nga shërbimet 2,000.00 euro
 - Të ardhurat bruto nga qiraja 1,000.00 euro

- Detyrimi tatimor nga shembulli nr.1
 - Të ardhura nga tregtia $5,000.00 * 3\% = 150.00\text{€}$
 - Të ardhura nga shërbimet $2,000.00 * 9\% = 180.00\text{€}$
 - Të ardhurat bruto nga qiraja $1,000.00 * 9\% = 90.00\text{€}$

- **Tatimi:** Shuma për pagesë tremujore = 420.00€

Raportimi i të ardhurave nga Korporatat e mëdha

Personat juridikë (Korporatat) me të ardhura vjetore bruto mbi limitin prej 30,000€, apo ata të cilët vullnetarisht zgjedhin të mbajnë libra dhe regjistrime sipas tatuarjes në të ardhura reale, do të raportojnë të ardhurat nga veprimtaritë afariste në periudhën tatimore gjatë së cilës janë pranuar apo akruar (lindur).

Kush ka për obligim të dorëzojë deklaratën vjetore – CD?

- Korporata e madhe;
- Korporata e vogël e cila zgjedh të tatóhet në baza reale;
- Organizata jo-qeveritare (OJQ);
- Një shoqëri tregtare me pronësi shoqërore apo publike;
- Njësia e përhershme si dhe çdo organizatë tjetër që e ka statusin e personit juridik.

Të ardhurat

- Të ardhurat, burimi i të cilave është brenda Kosovës, e të cilat përfshijnë:
 - Të ardhurat nga veprimtaritë afariste të ushtruara në Kosovë;
 - Të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së tundshme dhe të patundshme në Kosovë;
 - Të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së paprekshme në Kosovë;
 - Interesi mbi obligimin e borxhit të paguar nga një rezident apo autoritet publik;
 - Dividendët e paguara nga një organizate afariste rezidente;
 - Fitimin nga shitja e pasurisë së luajtshme, të paluajtshme dhe letrave me vlere në Kosovë;
 - Të ardhura tjera që nuk janë përmendur më lartë, por që rezultojnë nga veprimtaria ekonomike në Kosovë.
- Të ardhurat, burimi i të cilave është jashtë Kosovës.

Shpenzimet e pranueshme plotësisht dhe pjesërisht sipas Ligjit për TAK

- Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promocionit ekonomik;
- Shpenzimet e borxhit të keq;
- Shpenzimet afariste të udhëtimit;
- Shpenzimet e zhvlerësimit;
- Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja;
- Riparimet dhe përmirësimet;
- Shpenzimet e amortizimit;
- Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore;
- Humbjet tatimore (4 vite TAK);
- Shpenzimet e qirasë;
- Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik;
- Sponsorizimet;
- Shpenzimet edukative/arsimore dhe trajnuese etj.

Shpenzimet të cilat nuk pranohen sipas Ligjit për TAK

- Shpenzimet e përvetësimit dhe përmirësimit të Tokës;
- Shpenzimet e përmirësimit, renovimit dhe rikonstruksionit të mjeteve të cilat janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar (trajtohen si riparimet dhe përmirësimet);
- Gjobat, ndëshkimet dhe interesi që shqiptohen, si dhe shpenzimet dhe i lidhur me to;
- Tatimi në të ardhura i paguar apo akruar;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim;
- Shpenzimet personale, të jetës ose ato familjare;
- Çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur nëse nuk është në harmoni me Vlerën e Tregut;
- Kontributet Pensionale mbi shumën maksimale të lejuar me ligji;
- Shpenzimet për dhurata, përveç atyre që janë me emër dhe logo të biznesit të cilat janë pjesë e shpenzimeve të përfaqësimit;

Shpenzimet të cilat nuk pranohen sipas Ligjit për TAK (vazhdim)

- Humbjet në peshë specifike apo substancë, dëmtimet, mbetjet, tepricat, shkatërrimet apo thyerjet gjatë prodhimit, transportit, magazinimit dhe ekspozimit, përtej normave të përcaktuara me akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;
- Përfitimet në natyrë në formë të shujtës dhe transportit, përveç rasteve kur organizohet nga biznesi;
- Shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve rezident dhe jo rezident;
- Shpenzimet e mbuluara nga grantet subvencionet dhe donacioneve në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- Shpenzimet për dëfrim dhe rekreacion;
- Shpenzimet tjera të përcaktuara me legjislacionin tatimor në fuqi; dhe
- Shpenzimet e pa dokumentuara.

Deklarimi dhe pagesa e TAK

Këstet paradhënie

Për dorëzimin e kësteve paradhënie, ekzistojnë kritere për:

- Vitin e parë të afarizmit;
- Vitin e dytë të afarizmit, e tutje.

Deklarimi i kësteve paradhënie

Viti i parë i afarizmit

- $1/4$ e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit;
- Pagesa në katër këste, ku me pagesën e këstit të katërt mbulon **80%** të obligimit tatimor.

Deklarimi i kësteve paradhënie

Viti i dytë i afarizmit e tutje

Tatimpaguesi mund të zgjedhë njërin nga opsionet, si:

- **1/4** e detyrimit të përgjithshëm tatimor për periudhën tatimore në vijim bazuar në të ardhurën e tatueshme të vlerësuar dhe të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit, apo
- **110%** të detyrimit tatimor nga viti paraprak të zvogëluar nga cilado shumë e mbajtur në burim gjatë tremujorit.

Këstet paradhënie

Përrjashtimet:

- Tatimpaguesi i cili krijon humbje;
- Tatimpaguesi tek i cili ushtrohet kontrolli tatimor dhe devijimi kalon mbi 20% në atë vit.

Shembulli 1– Deklarimi me formularin QL

- Biznesi “X”, gjatë periudhës **TM1/2024**, ka këtë detyrim tatimor të parashikuar (Opsioni A) për vitin e tanishëm:
 - Të ardhura e parashikuara $1,000,000.00 / 4 = 250,000.00\text{€}$
 - Shpenzimet e parashikuara $800,000.00 / 4 = 200,000.00\text{€}$
- ---

Fitimi i paraparë për periudhën tremujore = $50,000.00\text{€}$
- ---

Tatimi: Shuma për pagesë tremujore = $5,000.00\text{€}$

Shembulli 2– Deklarimi me formularin QL

- Biznesi “X”, gjatë periudhës **TM1/2024**, ka përzgjedhë Opsionin “B” për të deklaruar këstet e vitit aktual. Pra, këstet paradhënie për vitin **2024** do ti deklaroj 110% më tepër se sa obligimi i vitit të kaluar.
- Obligimi tatimor në vitin e kaluar ishte 18,182.00€
- Pagesë paradhënie me 110%
 - Obligimi tatimor - pagesë paradhënie për vitin e tanishëm $18,182.00 + 10\% = 20,000.00 / 4 = 5,000.00\text{€}$

Afatet kohore për deklarim - TAK

- Secili tatimpagues i cili realizon apo akruon të ardhura nga veprimtaritë afariste paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga Administrata Tatimore në një bankë apo institucion financiar të licencuar nga BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar).
- Për këstet paradhënie, afati i deklarimit nga 1 deri më 15 të muajit vijues pas çdo tremujori.
- Për deklaratën vjetore për TAK afati i deklarimit nga 1 Janar deri më 31 Mars të vitit pasues të periudhës tatimore.

Plotësimi i tabelave përcjellëse për harmonizim

Udhëheqjen e kontabilitetit financiar për nevoja të Korporatës dhe harmonizimi sipas kërkesave ligjore.

Paraqitja e diferencave:

- Diferencat e përkohshme tatimore;
- Diferencat e përhershme tatimore.

Përpilimi i deklaratës tatimore

Deklarata tatimore konsiderohet vlerësim i bërë nga vet tatimpaguesi dhe përmban:

Deklaratën financiare

- Të ardhurat bruto;
- Shpenzimet.

Përpilimi i deklaratës tatimore

Deklaratën tatimore

- Të ardhurat e tatueshme (fitimi/humbja);
 - Rregullimet e të hyrave dhe shpenzimeve;
 - Tatimi i mbajtur në burim gjatë vitit;
 - Tatimin për pagesë;
 - Kërkesë për rimbursim.
-
- [Tabelat për rregullimin e tatimit në TAK.pdf](#)

Përpilimi i deklaratës tatimore

Shuma përfundimtare e tatimit, është shuma e përgjithshme e tatimit për periudhën tatimore minus:

- Shumat e Tatimit të Mbajtur në Burim dhe të paguara nga të tjerët;
- Shumat e paguara në këste tremujore - paradhënie;
- Krediti i jashtëm tatimor i lejuar sipas Ligjit për TAK.

Përpilimi i deklaratës tatimore

Varësisht nga kalkulimet mund të paraqiten këto situata:

- Obligim për pagesë;
- Pagesë tepër;
- Kërkesë për Rimbursim.

Deklarimi i CD-së përmes Sistemit EDI

www.atk-ks.org

The screenshot shows the registration page of the Tax Administration of Kosovo. It features a header with the logo and navigation menu. The main content area is titled "Kyçu" (Registration) and includes a form with fields for "Shtetëzuesi" (ID Number) and "Fjalëkalimi" (Password). Below the form is a "hexx" logo and a "Kyçu" button. To the right of the form, there are links for "Nuk keni flogari të hapur?", "Regjistrohuni si Biznes", "Regjistrohuni si Individ", and "Keni harruar fjalëkalimin? Rigjenero". At the bottom, there is a link "Për të ndryshuar e-mail adresën klikoni këtu".

The screenshot shows the user profile page of the Tax Administration of Kosovo. The header includes the logo, navigation menu, and user information: "601136177 | TEST CORP™ | beharhasri@gmail.com | Kyçu". The main content area is titled "Pasqyra e tatimpaguesit" (Taxpayer Profile) and contains a dropdown menu for "Deklarimi i Tatimeve" (Tax Declaration) with a red arrow pointing to it. Below the menu, there are sections for "Njësitë" (Units), "Informata mbi veprimtarinë" (Business Activity Information), and "Majtësi i Librave/kontabilitetit" (Accounting Books/Accountant Information).

NRB	Emri	Kryesore	Data e fillimit	Data e mbylljes
9999999	TEST CORP™	PO	28.10.2009	

NR	Personal / NJL	1174704577
Emri / Biznesi	Behar Vershevc	
Telefoni	0441111118	
Email adresa	beharhasri@gmail.com	

Shembull – Deklarimi Vjetor me formularin “CD”

Kompania “X” SHPK, gjatë periudhës 2023, ka pasur transaksionet si në vijim:

TË ARDHURAT	
Të ardhurat bruto	700,000.00 €
Të Ardhurat me Burim të Huaj	7,800.00 €
Arkëtimi i Borxheve të Këqija	2,000.00 €
Të ardhura/fitime të tjera	1,400.00 €
Gjithsej të ardhurat	711,200.00 €

SHPENZIMET	
Shpenzimet e pazbritshme	2,500.00 €
Shpenzimet e përfaqësimit	2,800.00 €
Lejimi special për asetet e reja	1,200.00 €
Shpenzime të tjera	250.00 €
Pagat bruto	18,000.00 €
Shpenzimet për zhvlerësim dhe amortizim	35,160.00 €
Shpenzimet e shitjes	5,200.00 €
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	60,000.00 €
Shpenzime tjera operative	5,000.00 €
Totali i shpenzimeve	130,110.00 €

INFORMATA TJERA	
Humbjet e bartura nga viti 2022	2,000.00 €
Kreditimi tatimor nga shtetet e huaja	2,000.00 €
Këstet e paguara	5,200.00€
Stoku në fillim, më 01.01.2023	350,000.00 €
Blerjet gjatë vitit 2023	240,000.00 €
Stoku në fund, më 31.12.2023	130,000.00 €
Sponsorizime	5,000.00 €

■ Zgjidhja:

Obligimi për pagesë = 1,913.30€

Deklarimi i të ardhurave nga:

- **Ortakëria dhe Grupimi i personave**

Obligimi për deklaram nga Ortakëria

- Me ortakëri kuptojmë bashkimin e dy a më tepër personave për qëllime biznesi me të drejta dhe obligime të barabarta në kapital, fitim dhe humbje;
- Ortakëritë sipas ligjit obligohen të dorëzojnë deklaratë vjetore ku përfshihen të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e ortakëve, **pa obligim pagese**;
- Ortakëria apo grupimi i personave është përgjegjës për dorëzimin e deklaratave dhe kryerjen e pagesave të të gjitha tatimeve për të cilat ortakëria apo grupimi i personave bëhet i detyrueshëm (*si: TVSH, Tatim në Paga, Kontribute Pensionale, Tatim të Mbajtur në Burim, Tatim në Qira, etj.*).

Obligimi për deklarin nga Ortakëria

- Ortakëritë dhe grupimi i personave, si dhe ortakët e ortakërive dhe anëtarët e grupeve, duhet të mbajnë libra dhe regjistrime në përputhje me paragrafin 5 të nenit 33 të Ligjit për TAP dhe secili ortak duhet të paguajnë tatimet në të ardhura obligative në përputhje me paragrafin 2.2 të nenit 43 të Ligjit për TAP;
- Ortakët mund t'i shkarkojnë një të një nga deklaratat sipas opsioneve të zgjedhura (IL, QL, PD, CD).

Si duhet të deklarojë Ortakëria?

- **Ortakëria** nuk do të mund të shkarkoj këto deklarata: IS, IL, QS, QL, CD, PD.
- Ortakëritë dhe grupimi i personave, si dhe ortakët e ortakërive dhe anëtarët e grupeve, duhet të mbajnë libra dhe regjistrime në përputhje me paragrafin 4 të nenit 33 të Ligjit Nr. 05/L-028 për TAP dhe secili **ortak** duhet të paguajnë tatimet në të ardhura obligative në përputhje me paragrafin 2.2 të nenit 43 të Ligjit për TAP.
- **Ortakët** mund t'i shkarkojnë njëren nga deklaratat sipas opsioneve të zgjedhura IL, QL, PD, CD, varësisht nga statusi i Ortakut.

Shembulli – Deklarimi Vjetor me formularin “DO”

Ortakëria “TEST CORP”, përbehet nga ortakun “T” dhe “C”.

Për vitin 2024 Pasqyra e të Ardhurave, kishte këtë gjendje:

TË ARDHURAT	
Të ardhurat bruto	600,000.00 €
Arkëtimi i Borxheve të Këqija	5,570.00 €
Gjithsej të ardhurat	605,570.00 €

SHPENZIMET	
Shpenzimet e pazbritshme	1,250.00 €
Pagat bruto	8,900.00 €
Shpenzimet për zhvlerësim dhe amortizim	1,800.00 €
Shpenzimet e shitjes	1,000.00 €
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	1,600.00 €
Shpenzime tjera operative	480.00 €
Totali i shpenzimeve	15,030.00 €

INFORMATA TJERA	
Stoku në fillim, më 01.01.2024	189,000.00 €
Blerjet gjatë vitit 2024	264,000.00 €
Stoku në fund, më 31.12.2024	178,000.00 €

■ Zgjidhja:

- Fitimi i axhustuar = 318,040.00 Euro
- E ardhura për Ortakun “T” = 159,020.00 Euro
- E ardhura për Ortakun “C” = 159,020.00 Euro

Deklarimi i të ardhurave nga:

- Individët

Formulari “DI” për Deklarimin Vjetor të TAP nga Individët

- Deklarimi i Tatimit në të Ardhura Personale përmes formularit “DI-FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESËS PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE PËR INDIVID” kërkohet të bëhet nga secili individ i cili realizon të ardhura për të cilat nuk i është mbajtur tatimi në burim nga paguesi i tyre, përveç individëve që zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe kanë statusin “Biznes Individual”, të cilët taten në të ardhura reale dhe deklarojnë me formularin PD - Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për Tatimin në të Ardhurat Personale.
- Për të deklaruar Tatimin në të Ardhura Personale, individi përmes numrit personal duhet të regjistrohet në Sistemin Elektronik EDI. Pasi të regjistrohet, ATK i dërgon fjalëkalimin përmes të cilit individi mund të përdor sistemin elektronik EDI.
- Për t’u deklaruar Tatimi në të Ardhura Personale, nga Individi kërkohet që paraprakisht të plotësohet pyetëtori i hartuar me pyetjet lidhur me të ardhurat e realizuara gjatë periudhës (vitit), si dhe shpenzimet e lejuara me Ligj.

Pyetjet në Formularin “DI”

1. A keni realizuar të ardhura nga Paga?
2. A keni realizuar të ardhura nga Pensioni
3. A keni realizuar të ardhura nga Interesi bankar?
4. A keni realizuar të ardhura nga Interesi në Huatë?
5. A keni realizuar të ardhura nga Fitoret në lotari?
6. A keni realizuar të ardhura nga Pasuria e Paprekshme?
7. A keni realizuar të ardhura nga Fitimet kapitale?
 - 7.1. A keni realizuar të ardhura nga shitja e Pasurisë së Paluajtshme (Tokë, Shtëpi, Banesë, Pronë tjetër)?
 - 7.2. A keni realizuar të ardhura nga shitja e Pasurisë së Luajtshme (Vetura, mjete tjera)?
 - 7.3. A keni realizuar të ardhura nga shitja e Pasurive tjera (Letra me vlerë, kriptovaluta, etj.)?
8. A keni realizuar të ardhura me burim nga jashtë?
9. A keni realizuar të ardhura nga Dhuratat?
10. A keni realizuar të ardhura tjera të cilat nuk janë përfshirë në pyetjet nga 1 deri 9?

Pyetjet në Formularin “DI”

11. A keni realizuar të ardhura nga qiratë?
12. A keni realizuar të ardhura nga Dividenda?
13. A keni realizuar të ardhura nga kompensimet për dëmtimin ose shkatërrimin e pronës?
14. A keni realizuar të ardhura nga polisat e sigurimit të jetës që paguhen si rezultat i vdekjes së personit të siguruar?
15. A keni realizuar të ardhura nga pagat si person me nevoja të veçanta?
16. A keni realizuar të ardhura nga pagesat e pensioneve dhe asistencat sociale të paguara nga Qeveria e Kosovës?
17. A keni realizuar të ardhura nga trashëgimia, si dhe dhuratat deri në 5,000 euro?
18. A keni realizuar të ardhura për shpronësimet nga shteti për interesa publike?
19. A keni realizuar të ardhura si dëmshpërblime nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave?
20. A keni realizuar të ardhura në formë shpërblimi nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport dhe kulturë?
21. A keni realizuar të ardhura si rezultat i kompensimit financiar si ish i dënuar politik?
22. A keni realizuar të ardhura nga grantet, subvencionet dhe donacionet?
23. A keni realizuar të ardhura tjera të cilat nuk janë përfshirë në pyetjet nga 12 deri 22?

Pyetjet në Formularin “DI”

24. A keni paguar Kontribute Pensionale apo a ju janë ndalur në burim Kontributet Pensionale nga Punëdhënësi?
25. A ju është mbajtur tatimi në burim në Paga nga punëdhënësi juaj?
26. A ju është mbajtur tatimi në burim në Pagesat e Pensionit?
27. A ju është mbajtur tatimi në burim mbi interesin bankar?
28. A ju është mbajtur tatimi në burim mbi interesin nga huatë?
29. A ju është mbajtur tatimi në burim mbi fitoret në lotari?
30. A ju është mbajtur tatimi në burim për pasuritë e paprekshme?
31. A ju është mbajtur tatimi në burim për të ardhurat e realizuara jashtë vendit?
32. A ju është mbajtur tatimi në burim për të ardhurat nga qiratë?

Shembull: Deklarimi Vjetor me formularin “DI”

Personi fizik jo-afarist “Filan Fisteku”, gjatë vitit 2024, ka realizuar të ardhura nga burime të ndryshme, si:

LLOJI I TË ARDHURAVE	Shuma
Të ardhurat bruto nga pagat	18,000.00
Të ardhurat bruto nga interesi bankar	1,000.00
Të ardhurat nga fitimet kapitale	71,000.00
a) Shitja e Tokës dhe Banesës 20,000.00	
b) Shitja e Veturës 1,000.00	
c) Kriptoalutat 50,000.00	
Të ardhurat me burim nga jashtë	12,000.00
Të ardhurat bruto nga qiratë	24,000.00
Të ardhurat bruto nga dividenta	6,000.00
Të ardhurat e përfituara nga grantet, subvencionet dhe donacionet	3,000.00

ZBRITJET	Shuma
Shpenzimet për kontributet pensionale	900.00
Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e qirasë -10% e qirasë bruto	2,400.00

TATIMET E MBAJTURA NË BURIM	Shuma
Tatimi i mbajtur në burim në paga nga punëdhënësit	1,443.00
Tatimi i mbajtur në burim mbi interesin bankar	100.00
Kreditimi i tatimit të huaj	1,200.00
Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë	2,160.00

■ Zgjidhja:

Obligimi për pagesë = 7,019.00€

Plotësimi i formularit “DI” përmes Sistemit Elektronik EDI

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndhimë Kontakti ALB SRB ENG

Deklarimi i Tatimeve

2024

#	Lloji i tatimit	Muaji	Viti	Afati
11	[IL] Kestet tremujore për Bizneset e Mëdha Individuale	12	2024	15.01.2025
12	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	10	2024	20.11.2024
13	[WR] INT,DIV,RENT M.BURIM	10	2024	15.11.2024
14	[WM] Pasqyra mujore e tatimit në burim	10	2024	15.11.2024
15	DI		2024	31.03.2025
50				

1 2 50 rreshta për faqe 1 - 50 prej 62 rreshtave

Deklaro

Afatet e deklarimit dhe pagesa e tatimeve

- Të gjitha tatimet dhe kontributet deklarohen vetëm në mënyrë elektronike përmes Sistemit Elektronik EDI

Nr.	Emërtimi i Formularit	Shkurtesa	Afati i deklarimit
1	Formulari i deklarimit dhe pagesës së TVSH	TV	Prej 1 deri 20 të çdo muaji
2	Pasqyra mujore e tatimit në burim në paga dhe kontribute pensionale	WM/CM	Prej 1 deri 15 të çdo muaji
3	Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes, të drejtat pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit dhe personin jo-rezident	WR	Prej 1 deri 15 të çdo muaji
4	Pasqyra tremujore mbi qiranë dhe pasurinë e patrupëzuar	IR	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori
5	Pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e vogla individuale	IS	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori
6	Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për bizneset e mëdha individuale	IL	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori
7	Pasqyra tremujore e pagesës së tatimit për korporatat e vogla	QS	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori
8	Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për korporatat e mëdha	QL	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori
9	Formular i Deklarimit vjetor dhe pagesën për tatimin mbi të Ardhurat Personale	PD	Prej 1 janar deri 31 mars
10	Formular i Deklarimit vjetor dhe pagesën për tatimin në të Ardhurat e Korporatave	CD	Prej 1 janar deri 31 mars
11	Formular i Deklarimit vjetor dhe pagesën për tatimin mbi të Ardhurat Personale - Individ	DI	Prej 1 janar deri 31 mars
12	Deklarata e Tatimit në të Ardhurat nga Ortakëria	DO	Prej 1 janar deri 31 mars
13	Kërkesa për Rimbursim /Kthim	KRR	Prej 1 deri 20 të çdo muaji apo tremujori
14	Deklarimi i Librit të Blerjes nga Deklaruesit e TVSH-së	LB	Prej 1 deri 20 të çdo muaji
15	Deklarimi i Librit të Shitjes nga Deklaruesit e TVSH-së	LSH	Prej 1 deri 20 të çdo muaji
16	Deklarimi i Librit të Blerjes nga personat tjerë	LB	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori
17	Deklarimi i Librit të Shitjes nga Personat tjerë	LSH	Prej 1 deri 15 të çdo tremujori
18	Deklarimi i Raportit të blerjeve mbi 500€	RB	Prej 1 janar deri 31 mars
19	Deklarimi i Pasqyrave Financiare	PF	Prej 1 janar deri 31 mars

Ndëshkimet

- Kur një person nuk e dorëzon një deklaratë tatimore të obligueshme sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës në afatin e përcaktuar, e cila rezulton me detyrim tatimor, i nënshtrohet gjobës prej:
 - 50.00€ për personin fizik afarist, për çdo deklaratë të pa deklaruar;
 - 150.00€ për personin juridik, për çdo deklaratë të pa deklaruar;
 - 20.00€ për personin fizik jo afarist, për çdo deklaratë të pa deklaruar.
- Interesi për mos pagesën e tatimit 0.65% në muaj apo pjesë të muajit.

Koha për pyetje dhe përgjigje



Materiale informuese



Avantazhi i Tatimpaguesve



Qendrat e shërbimit



Marrëveshtja për eliminimin e
Tatimit të Dyfishtë



Përfaqësi shqiptare e bashkëpunimit
ATK në



Plihi strategjik 2022-2025



Përmbushja tatimore



Tatimi në të ardhurat personale



Tatimi në të ardhurat e korporatave



Niveli i Paqije Fiskale dhe Irbho
Kupon Fiskal



Të drejtat dhe detyrimet e
tatimpaguesit



Zyra për gabat dhe ndëshkime
administrative



Udhëzuesin për dorëzimin e përkohshme
Kupon Fiskal në ATK



Fytxa - përgjigje për tatimorë të
ardhur personale



Fytxa - përgjigje për tatimorë të
ardhur të korporatave



Të drejtat dhe detyrimet e
tatimpaguesit gjatë kontrollit



Të ardhurat taksat



Përmes materialeve informuese, të gjithë personat mund të informohen më për së afërmi për obligimet e tyre tatimore, si: mënyrën e regjistrimit, mbajtjes së dokumentacionit, deklarimit dhe pagesës së tatimeve dhe kontributeve, në përputhje me Legjislacionin tatimor në fuqi.

[Linku për materiale informuese](#)

Zyra Qendrore
Departamenti i Regjistrimit dhe Shërbimit të
Tatimpaguesve
Tel: +381 (38) 200 250 17

Ueb faqja: www.atk-ks.org
Adresa elektronike: info@atk-ks.org

Adresa:
Drejtoria e Përgjithshme
Këndi i rrugëve “Dëshmorët e Kombit” dhe
“Bill Clinton” 10 000 Prishtinë, Kosovë



Vizitoni ueb faqen e ATK-së

www.atk-ks.org



Shërbimet Elektronike

Deklarimi Elektronik

ri terminologjik

rko deklaratën elektronike

zuesi Interaktiv

Vërtetimi Tatimor

Kërko tatimpaguesin

Kalkulatorët

Denonco

Raporto blerjet mbi 500 Euro

Libri i blerjes dhe i shitjes

✓ Verifikimi i regjistrimit nga punëdhënësi

☰ Monitoro Denoncimin

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

Informatat

€ Tatimet

📁 Arkat fiskale

📄 Numrat fiskal

👤 Pensionet

👤 Tatimpaguesit jo-aktiv

👤 Mbledhja e detyrueshme

📄 Lista e Vërtetimeve Tatimore të anuluar nga ATK

👤 Avokati i tatimpaguesve

📄 Informata të përgjithshme mbi tatimet

📄 Zyra për Gjopa dhe Ndëshkime